

YLL RUGOVA

KATEKIZMI I ELBASANIT ME ALFABETIN E TODHRIT NGA MESI I SHEKULLIT XIX

Abstrakt

Në mesin e kodikëve që ndodhen në AQSH është edhe një fletore nga Elbasani me shkrime në gjuhën greke, në mesin e të cilave janë edhe disa faqe në shqip me alfabetin e Todhrit. Përmbajtja e shkrimit është një katekizëm i botuar nga Adamantios Korais (1748–1833) përkthyer në shqip nga një autor i panjohur elbasanas. Në këtë artikull do ta botojmë të plotë tekstin shqip të fletores të transliteruar dhe do ta përcjellim atë edhe me të dhëna që dihen mbi këtë fletore dhe mbi pronarin e fundit të saj. Përkthimi ka rëndësi sepse në aspektin pamor përbën shembullin më të mirë të shkrimit me alfabetin e Todhrit që njohim deri sot. E gjithashtu në aspektin përmbajtësor shpërfaq fragmente të rralla që ndriçojnë arsyet e autorëve të kohës në angazhime të tilla përkthyesë. Botimi i plotë i këtij teksti, kemi shpresë, mund të ndikojë edhe në zbardhjen e të dhënave të tjera që lidhen mbi të gjitha me kohën dhe me autorin e përkthimit.

Fjalët kyçe: *Katekizmi i Elbasanit, Theodor Haxhifilipi, Papa Partheni, Petër Shuteriqi, alfabeti i Todhrit*

Fletorja e Elbasanit

Para vitit 1954 në Arkivin e Institutit të Historisë, sot Arkivi Qendror i Shtetit, është dorëzuar një fletore nga Elbasani me përmbajtje të përzier shkollore e fetare me pronar të fundit Petër Shuteriqin, i vdekur në vitin 1904. Fletorja në pjesën më të madhe të saj ka shënime didaktike greqisht me alfabet grek. Por në disa faqe të mesit janë edhe 24 faqe shqip të shkruara me alfabetin e Todhrit, përkatësisht nga faqja 34 recto deri te 45 verso sipas numërimit që ndodhet në fletore bërë nga arkivistët. I gjithë materiali, të cilin nuk e kemi parë të plotë, qysh mësojmë nga një përshkrim që i bën Çunga (2018, 7), ka 89 fletë. Prej tij, në formë fotografish digjitale të cilësisë së mirë, kemi pasur para vetës 24 fletët e katekizmit, të cilat i kemi transliteruar. Përveç tyre e kemi parë edhe ballinën, faqen e parë, dhe faqen 46 recto të cilat janë kryesisht me germa

greke, dhe me ndonjë fjalë me germa arabe.¹ Të gjitha këto faqe na janë vënë në dispozicion duke iu falënderuar rizbuluesit të fletores, për të cilin do të flasim prapë. Faqet me shkrimin e Todhrit janë të ruajtura mirë dhe teksti është lehtë i lexueshëm. Më së hershmi për këtë fletore na ka folur Shuteriqi në vitin 1954:

Në mes të dorëshkrimeve fetare, që mund të jenë punë e klerikëve, duhen zënë me gojë edhe këto, që janë sigurisht të pjesës së dytë së sh. XIX: *Për të kateqismen dhe Aan e paar për të ngjoftmen e Perëndiis vetëm qi na çon drejt ke besa ungjillit*. Janë të parat kateqisma që njohim elbasanisht. Ruhet në AH, 4, të lidhura në një radhua me shkrime të ndryshme greqishte. Radhoi ka qenë pronë e mësonjësit Petër Shuteriqi, vdekur më 1904. (Shuteriqi 1954, 54)

dhe më pas në vitin 1959:

Këto dy dorëshkrime, *Për të kateqismen dhe Aan e paar për të ngjoftmen e perëndiis verëm qi na çon drejt ke besa e ungjillit*, janë lidhur së bashku me dorëshkrime të tjera greqishte në një radhua të madh të ASH, 4. Shkrimi është mjaft i bukur e i sigurt, pikësimi në rregull, gjë që bën kontrast me gjithë dorëshkrimet e tjera që njohim me alfabetin e Todhrit; kjo të bën të mendosh se ai që i shkroi, ishte njeri me një farë përgatitje. (Shuteriqi 1959, 185)

Përveç këtyre dy dromcave të hershme për katekizmin, si për shumë dokumente të tjera me alfabetin e Todhrit, nuk kemi hasur të dhëna të tjera. Fletorja duket të ketë humbur për një kohë në mesin e dorëshkrimeve të shumta të AQSH-së, kur në vitin 2018 e rizbuloi arkivisti dhe paleografi Sokol Çunga, i cili e shtoi atë në Fondin *Kodikët e Shqipërisë*, Dosja nr. 109. Sipas Çungës, fletorja duhet të jetë shkruar nga ndonjë nxënës i kohës. Ky na jep edhe disa informata shtesë:

Shkruar në gjysmën e dytë të shek. XIX. Përmban 89 fletë letre me përmasa 203 x 145 mm. Dorëshkrimi (figura 6) është pajisur me kapakë kartoni, veshur [m]e lëkurë, pak të dëmtuar. Lidhja e mirë. [...] Data e shkrimit/kopjimit na është e panjohur, po ashtu dhe autori. Disa herë gjatë dorëshkrimit shfaqet emri Petro Shuteriqi, shkruar me alfabetë të ndryshëm. (Çunga 2018, 7–8)

¹ Për një përshkrim të plotë të fletores shih Çunga 2018, 7-8.

Në faqen e fundit të fletore, Çunga ka vërejtur edhe një kopje të firmës së Patriarkut Ciril të Konstandinopojës të shkruar greqisht, çka na bën të mendojmë se kemi të bëjmë me periudhën 1855–1860, kur Cirili VII ka mbajtur këtë post. Përveç shkrimit me alfabetin e Todhrit, fletorja ka edhe një fjalor ca faqësh greqisht–shqip me germa greke, për të cilin nuk do të bëjmë fjalë këtu. Ndonëse ka pak hapësirë për dyshim se dorëshkrimi i përket gjysmës së dytë të shekullit XIX, asgjë nuk na kufizon ta shqyrtojmë vetë përkthimin shqip të katekizmit si më të vjetër. Është një e dhënë brenda parathënies së tekstit që na lejon ta zgjerojmë harkun kohor të mundshëm. Në një pasazh autori shpjegon si e ka përkthyer katekizmin dhe nga kush, dhe thotë “masi gjeta këtë Kateqise gërqisht që ekaa nxjeerr Koraiu, ubaash mukajet nde un e exora më gjuhunët shqipes toon për fajden e gjith hrishtënimit.” Bëhet fjalë për një katekizëm të iluministit grek Adamantios Korais (1748–1833),² i cili qe një figurë me shumë ndikim në zhvillimet e mëvonshme arsimore e gjuhësore të popullit grek. Përkthimi i Elbasanit është një dëshmi se ndikimi i këtij autori iluminist kish depërtuar edhe në mesin e shqiptarëve.³ Qysh e kemi vërejtur nga teksti burimor të cilin patëm rastin ta shohim, katekizmi i Koraiut nuk është përpilim origjinal i tij, por përkthim i një katekizmi të mëhershëm nga Mitropolit i Moskës Platon Levshin (1737–1812). Koraiu këtë përkthim greqisht e ka botuar së pari në vitin 1782 në Saksoni.⁴ Kjo datë na jep një *terminus post quem*, e ndoshta edhe një pikë orientuese për periudhën e përkthimit shqip. Gjithsesi, vepra e Koraiut ishte ribotuar edhe disa herë të tjera më 1827, 1836, 1851 dhe 1887. Botimi i vitit 1827 qe bërë në Korfuz. Nëse marrim afërsinë gjeografike si faktor, ky botim i Korfuzit duket më i mundshmi të ketë qenë pranë përkthyesit elbasanas.⁵ Por kjo kurrsesi nuk e përjashton asnjërin nga botimet dhe periudhat e tjera nga viti 1782 e tutje.

Botimi i tekstit të transliteruar me alfabetin e sotëm të gjuhës shqipe mund të ndihmojë në krahasimin e gjuhës me dorëshkrimet e tjera të Elbasanit; duke

² Për një biografi të hershme, të zgjeruar enciklopedike të Koraiut khs. De Sinner 1936, 358–375; Një përmbledhje më e re, me ca të dhëna bibliografike khs. Franghiscos 2005, 93–128. Studiuesi slloven Rajko Nahtigal në vitin 1923 i konsideronte Koraiun dhe Haxhifilipin si bashkëmoshatarë, dhe përfaqësues të së njëjtës frymë ideologjike, khs. Nahtigal, 2015, 86–87.

³ Koraiu kishte pasur ndikim edhe në rininë e Thimi Mitkos, qysh vërehet nga një letër e këtij të fundit nga viti 1844 (Qirjazi, 2015a, 48).

⁴ Një vit më vonë Korai ka botuar edhe një katekizmi në greqisht *Συνοψις της Ιερας Ιστοριας και της κατηχησεως* shtypur këtë herë në Venedik. Por nga përmbajtja e tekstit, është e qartë se autori elbasanas nuk e ka pasur para vetës këtë veper.

⁵ Në të njëjtin vit dhe të njëjtën shtypshkronjë është shtypur edhe Bibla shqip e Meksit dhe Gjirokastritit.

filluar nga ato të Theodhor Haxhifilipit që i takojnë dekadave të fundit të shekullit XVIII, e deri te tekstet e Papa Parthenit që i takojnë gjysmës së dytë të shekullit XIX.⁶ Krahasime të tilla me një vëzhgim adekuat specialistësh të fushës mund të ndihmojnë orientimisht në lokalizimin e kohës së përkthimit. Pa pretenduar të dalim jashtë domenit tonë të njohurive, është me rëndësi të vihet në pah se dorëshkrimi karakterizohet nga përdorimi jo-konsistent i hapësirave për të ndarë fjalët, çka mund të jetë dëshmi për tekst më të hershëm se gjysma e dytë e shekullit XIX (khs. Cipo 1964, 183–184). Në anën tjetër, disa raste ilustrjnë edhe ndikimin e gjuhës së Haxhifilipit në tekstin e përkthyer, fjalët si: *shtëpesë, laft, ditunii, eshk, dhidhaksun, dreejt, nde*⁷, *ndërtesë, nishan, nome, rixha, shenjtënushëm, tii, urdhënimi, profit, vërte, vërteet, xhdo* e ndonjë tjetër (khs. Shuteriqi 1959, 187–197).⁸ Në gjysmën e dytë të shekullit XIX nuk njohim në Elbasan ndonjë klerik e mësues me veçori intelektuale çfarë na figuron të ketë autori dhe përkthyesi i parathënies dhe katekizmit në fjalë.⁹ Përkthyesi duket të ketë qenë i vetëdijshëm për kompleksitetin e punës që kish përpara, dhe ishte i gatshëm që në rastet edhe të “shtojë” fjalë (nishan/nojma) të reja:

Shtova m’ate ende disa të nishanume rëposh sa kaa iktizaa gjuhuna shqipese të rrëfeej nojmat e gjuhunës gërqişes. Jukam rixhan praa juve të ghëshenvet shqiptarët të dheskni e ta duni këtë Katiqise si ushqimin e shpirtit tuuj, ta meletisni e ta këndonni përhera në daçi të merrni natediit të lumnumen prej zotit, në daçi ti bini pishqesh ndërtestarit toon të ngjoftmen eperndiis që asht si një kurban i shejtënushëm e i

⁶ Janë disa shkrime në AQSH që mbajnë emrin e Papa Parthenit, njëra prej të cilave është një meshë e Shën Efremit e shkruar në 18 faqe e datuar 6 shkurt 1878. Fondi Papa Parthemit (sic), D1–59, 78–83.

⁷ Për *dhe* dhe *edhe* te përkthimi elbasanas njësoj si te Haxhifilipi përdoren *nde* dhe *ende*. Këtë formë shumë rrallë e hasim në tekstet tjera elbasanase të kohës. Për Shuteriqin kjo ishte një ndër karakteristikat e Haxhifilipit (Shuteriqi, 1959, 191).

⁸ Një dallim që bien në sy është te fjala *zemër*, e cila te përkthimi elbasanas mban formën e sotme, kurse te Haxhifilipi shënohet si *zembër* (khs. Omari, 2018, 284; Shuteriqi 1959, 197). Fjala *koho* që njësoj është e shpeshtë në këtë përkthim haset edhe në shkrimet tjera të Elbasanit. E njëjta vlen edhe për fjalët *iktiza* e *rixha*. Për dallimet gjuhësore mes Todhrit dhe Parthenit shih edhe Gosturani, 1983, 87–99.

⁹ Natyrisht përjashtim këtu bën Kostandin Kristoforidhi, i cili në vitin 1885 ka shërbyer si mësues në Elbasan, por në këtë kohë tashmë kishte qenë tërësisht i dhënë pas dy alfabetëve të tij shqipe të bazuara në shkrimin grek dhe atë latin. Nuk dimë për ndonjë tekst të Kristoforidhit me alfabetin e Todhrit, edhe pse dy dokumente, njëri nga viti 1849 dhe tjetri nga viti 1854 dëshmojnë se ai e ka njohur mirë atë (Rugova, 2023).

pëlqyshëm ke aji që pa ibaam këtë kurban nuk a me mëqym kuurr të forcohi, më besët nde më punët emira.

Pra, duket se ky autor përveç që ka përdorur fjalë nga tekstet e mëhershme shqipe në Elbasan –ato të Haxhifilipit – për këtë përkthim ka sajuar edhe disa të reja.¹⁰ Në gjysmën e dytë të shekullit XIX kishte qenë aktiv në Elbasan Papa Partheni (v. 1901), kujdestar në manastirin e Gjon Vladimirit. Por sipas Shuteriqit, të paktën në një dorëshkrim që ka grafinë e Papa Parthenit “gjuha nuk na duket të jetë ajo e Todhrit”, kurse vëren edhe se ka siguri mjaft të madhe të gjuhës që sipas tij nuk është rasti edhe me Todhrit (khs. Shuteriqi 1959, 178).¹¹ Te shkrimet e Parthenit fjalët nuk janë të ngjitura si te përkthyesi elbasanas. Mbi të gjitha, dora në shkrimin e Parthenit me atë të përkthyesit elbasanas dallojnë rrënjësisht; po të ishte autor i përkthimit, duke qenë bashkëkohas, s’ka arsye mos të ketë qenë edhe dorëshkrues. Në vitet e fundit të shekullit XIX ka qenë shumë aktiv edhe Dhimitër Pina, me tekste shqip të shkruara me alfabetë të ndryshme. Por shkrimet e tij janë shumë moderne për t’u krahasuar me tekstin e katekizmit elbasanas. S’do mend se asnjëri nga argumentet e paraqitura nuk e përjashtojnë që pronari (mbase edhe kopjuesi) i fletores Petër Shuteriqi të jetë edhe autor e përkthyes i katekizmit, por për këtë figurë nuk kemi ndonjë informatë përveç asaj që u tha. Kërkime të reja mund të ndriçojnë më tutje çështjen e kohës dhe të autorësisë së përkthimit e kopjimit.

Përmbajtja dhe informatat teknike

Qysh mësojmë nga vetë teksti, kemi të bëjmë me dy pjesë të të njëjtit material: (1) një parathënie të përshtatur me disa dromca origjinale të përkthyesit; dhe me (2) një fragment fillestar jo të plotë të kapitullit të parë të katekizmit.¹² Ndërsa parathënia origjinale e Koraiut ka 20 paragrafë, ajo e përkthyesit elbasanas ka 18 (khs. Korais 1782, V–XXXII). Kjo shpjegohet edhe me faktin se në parathënie kemi pjesërisht të bëjmë me adaptim nga

¹⁰ Kjo fjali e shton edhe vetë Haxhifilipin në listë si autor të mundshëm të përkthimit. Ai gjithsesi njihet për fjalët që i ka “shtuar” dhe sajuar në tekstet e tij. Kjo do të nënkuptonte se ky përkthim i takon një periudhe më të hershme, diçka mes viteve 1782 dhe 1801. Rishtazi në AQSH e kemi rigjetur *Meshën e Gjon Gojartit*, si të vetmin dorëshkrim që në ballinë e mban emrin e Haxhifilipit. Shkrimi nën një lupë të re për këtë material është në botim, shih Rugova, 2023.

¹¹ Në një rast tjetër Shuteriqi vëren ndikimin e Haxhifilipit edhe te Partheni (cf. 1954, 46–51).

¹² Nga paragrafët që i paraqitëm në fillim vërehet se Shuteriqi i numëronte si dy tekste të ndara këto pjesë. Por krahasimi me veprën origjinale të Koraiut vërteton se kemi të bëjmë me një dhe të vetmin tekst, ku pjesa e parë përbën një lloj të parathënies, kurse pjesa e dytë është katekizmi.

përkthyesi, ani pse disa pika të para janë përkthime klasike. Në anën tjetër, pjesa e fragmentit fillestar të katekizmit ndërpritet në pak rreshta, dhe paraqet vetëm dy pika të përkthyer nga gjithsej 18 që i ka kapitulli i parë i katekizmit original (përkthyesi e quan “Aan epaar”). Për më shumë kapitulli i dytë dhe i tretë nuk figurojnë fare në përkthim, anipse ato janë në origjinal. Ata pak rreshta të fragmentit fillestar janë karakterizuar me shumë fusnota në origjinal, të cilat përkthyesi i Elbasanit është munduar t’i mbajë. Por pikën e parë të tekstit origjinal përkthyesi e ka hequr tërësisht, duke e vazhduar tekstin e tij vetëm nga pika 2 dhe tutje, të rinumëruar. Përgjithësisht, nga ajo që kemi vërejtur, botimi i Koraiut ka përmbytur të njëjtë me katekizmin e Elbasanit (khs. Korais 1782, 1–4). Më me rëndësi për nga përmbytja, mund të thuhet, është parathënia në të cilën autori jep një historik të katekizmit, me elemente origjinale për lexuesin shqiptar, çka flet për një nivel të caktuar intelektual të këtij përkthyesi elbasanas. Përballë kësaj, shkrimi i rregullt, me shenja të pikësimit, dhe gati pa gabime me alfabetin e Todhrit sinjalizon përdorim të shpeshtë dhe të vazhdueshëm të këtij alfabeti nga kopjuesi elbasanas. Është shembulli më i mirë që njohim i shkrimit me alfabetin e Todhrit.

Dorëshkruesi përdor – për herë të parë kaq dendur në një dorëshkrim me alfabet të Todhrit – shkronja të mëdha dhe të vogla. Ku shkronjat e mëdha janë zakonisht të njëjtat veç të rritura në madhësi;¹³ çka shpesh në këtë transliterim na ka shkaktuar probleme në dallimin e tyre. Shkrimi përfshin numrat e zakonshëm arabë që përdorim sot, e gjithashtu janë përdorur shenjat e pikësimit si pika, presja, pikëpresja, thonjëzat, kllapat dhe viza lidhëse. Në fillim të paragrafëve, kur i duhet, autori përdor shenjën e paragrafit §. Në ndonjë rast përdor pikëçuditësen, por asnjëherë pikëpyetësen, anipse në disa pjesë bën pyetje (fjalitë pyetëse i mbyll me pikëpresje). Dorëshkrimi ka dy lloje pikash në fund të fjalisë, njëra është kjo e zakonshme që e njohim në shkrimin latin, kurse tjetra është e ngritur më lart; pa ndonjë rregull që kemi mundur të identifikojmë. Pas pikës shkruasi herë e nis fjalinë me shkronjë të madhe, e herë me shkronjë të vogël, por në rastet kur pika është lart gjithmonë duket se e nis me të vogël. Mund të jetë kjo edhe ndonjë formë theksimi që autori e përdor. Në transliterim me germa të alfabetit të sotëm shqip që po botohet këtu nuk kemi vënë thekset në shkronja që janë në tekstin elbasanas, ngase ato shpesh janë të formës që nuk ndeshen te shkrimi latin, nganjëherë janë të dyfishta (një mbi një), e në ndonjë rast duket të jetë shtuar më vonë me një laps tjetër, që na bën të dyshojmë në funksionin që kanë. Përdorimi i tyre në transliterim, përveç që është teknikisht problematik, na është dukur se më

¹³ Përfashtim këtu bën germa O, e cila edhe në dorëshkrime të tjera dallon kur është e madhe te alfabeti i Todhrit. Njësoj përfashtim mund ta konsiderojmë germën I, e cila është stilizuar duke ndjekur I-në e madhe të shkrimit latin.

shumë mund të shkaktojë konfuzion sesa ndihmesë. Specialistët që kanë nevojë për këtë informatë duhet t'i referohen dokumentit original.

Alfabeti në katekizmin e Elbasanit																																			
v	o	q	q	λ	ç	i	o	h	h	ε	o	c	d	h	d	v	o	u	s	s	p	e	l	q	o	l	z	g	d	v	δ				
Vlerat fonetike sipas alfabetit të gjuhës shqipe																																			
a	b	c	ç	d	dh	e	ë	f	g	gj	h	i	j	k	l	ll	m	n	nj	o	p	q	r	rr	s	sh	t	th	u	v	x	xh	y	z	zh
Vlerat fonetike sipas IPA																																			
a	b	ts	tʃ	d	ð	e	ə	f	g	ɟ	h	i	j	k	l	ɫ	m	n	ɲ	o	p	c	r	s	ʃ	t	θ	u	v	dz	dʒ	y	z	ʒ	

Shenjat e alfabetit të Todhrit sipas formës që i ndeshim në katekizmin e Elbasanit: ato nuk dallojnë shumë për nga forma prej shkriemeve tjera me alfabetin e Todhrit që janë paraqitur nga Hahn (1850) dhe nga Kristoforidhi (1849). I vetmi dallim në germat e katekizmit është forma e tyre kursive. Është ndër herët e rralla që e hasim këtë alfabet në formë kursive (italike) në një tekst (një shembull tjetër është edhe radhoi i Tupe Ballës). Në një letër të Kristoforidhit të datuar 1854 në Durrës, përshkrimi i shkurtë i alfabetit të Todhrit është përcjellë me një tabelë të shenjave, ku ato janë njësoj kursive; por prej Kristoforidhit nuk dimë të ekzistojë ndonjë tekst i plotë me këtë alfabet.

Ligaturat e përdorura										Shenja me kuptim të pasigurtë			Shkronja të mëdha
y	ℓ	h	ç	s	z	o	x	dh	g	ə	ʃ	x	ω
ps	mb	ng	ngj	st	nx	sht	nd	yy	sk	h	gh	ks	O

Përveç 36 shenjave që përkohjnë me vlerat fonetike të alfabetit të sotëm të shqipes në fletoren e Elbasanit janë përdorur edhe 12 ligatura (germa të bashkuara). Prej tyre ligatura *sht* dhe *nd* është përdorur më së shumti. Ndërkohë që për dy ligatura të tjera *gh* dhe *ks* nuk jemi shumë të sigurt për vlerën e tyre, megjithëse ne i kemi paraqitur sipas përshkrimit në një dorëshkrim të hershëm nga Kristoforidhi të zbuluar rishtazi (khs. Qirjazi 2015b, 555–71). Përkthyesi

fjalën *i krishterë* e shkruan *i ghështen*,¹⁴ me këtë *gh*-në karakteristike të alfabetit të Todhrit. Sa për ligaturën *ks*, atë e ndeshim vetëm te një fjalë, ku përdoret në vend të ligaturës tjetër *sk*: dhidhasket e dhidhaks. Nuk kemi qenë të sigurt as për shenjën e dytë për *h* (shih tabelën), të cilën e kemi transliteruar me këtë vlerë, megjithëse te Kristoforidhi jepen njëra si *ha*, e tjetra si *chja*. Është për t'u theksuar përdorimi i ligaturës për *yy* të cilën nuk e kemi të paraqitur te Hahn. Dorëshkruesi përgjithësisht vazhdimin e një fjale në rreshtin tjetër e ka shënuar me dy viza paralele (si barazim), por në disa pjesë këtë vazhdim e ka lënë pa ndonjë shenjë. Në rastet kur është shenja e vazhdimit ne e kemi shënuar me vizën e zakonshme (hyphen), kurse aty ku nuk ka shenjë e kemi lënë ashtu si është. Teksti ka edhe fusnota, të cilat nganjëherë përcillen me shënime plotësues, e nganjëherë jo. Kjo mund të jetë edhe për faktin që teksti në fletoren e gjetur mbahet si fragment jo i plotë i përkthimit.

BIBLIOGRAFI

- Cipo, Kostaq (1964). “Një sy rreth dorëshkrimit të Simonit”, në *Studime filologjike*, Tiranë (1), 183–188.
- Çunga, Sokol (2018). “Dorëshkrime të reja në greqisht në Arkivin Qendror Shtetëror. Paraqitje e parë”, në *Shejzat: pleiades* (1–2), 3–18.
- De Sinner, Gabriel Rudolph Ludwig (1836). “Coray (Diamant)”, në *Biographie universelle, ancienne et moderne: Chi-Cz*, vëllimi 61. Paris, Michaud, 358–375.
- Franghiscos, Emmanuel N. (2005). “A Survey of Studies on Adamantios Korais During the Nineteenth Century”, në *The Historical Review/La Revue Historique* (2), 93–128.
- Gosturani, Xheladin (1983). “Dukuri fonetike në sistemin e zanoreve të së folmes së qytetit të Elbasanit”, në *Studime filologjike*, Tiranë (1), 87–99.
- Hahn, Johann Georg (1850). “Bemerkungen über das albanesische Alphabet”, në *Sitzungsberichte der Kaiserlichen akademie der Wissenschaften*, Vjenë, 5 (6–10), 841–867.
- Korais, Adamantios (1782). *Πλάτωνος Μητροπολίτου Μόσχας Ορθόδοξος Διδασκαλία εἶπουν Σύνοψις τῆς Χριστιανικῆς Θεολογίας Μετάφρασις Α. Κοραῆ [Mitropolititi i Moskës, Platoni, Mësimi ortodoks ose sinopsis i teologjisë së krishterë, përkthyer nga A. Korais]*. Lajpcig, Johann Gottlob Immanuel Breitkopf.
- (1783). *Συνοψις της Ἰερας Ἱστορίας και της κατηχησεως [Sinopsis i historisë së shenjtë dhe katekizmit]*. Venedik, Antonio Bartoli.
- (1827). *Πλάτωνος Μητροπολίτου Μόσχας Ορθόδοξος Διδασκαλία εἶπουν Σύνοψις τῆς Χριστιανικῆς Θεολογίας Μετάφρασις Α. Κοραῆ Νῦν τὸ*

¹⁴ Në vitin 1959 Shuteriqi e ka transliteruar thjesht si *gështen* (cf. Shuteriqi, 1959, 185).

Δεύτερον έκδοθεῖσα ὑπὸ Κ. Τυπάλδου Ιερομονάχου Ιερᾶς Θεολογίας ἐν τῇ Ἰονίῳ Ἀκαδημίᾳ Διδασκάλου [Mitropoliti i Moskës, Platoni, Mësimi ortodoks ose sinopsis i teologjisë së krishterë, përkthyer nga A. Korais, botuar nga K. Tupaldos, jeromonak i teologjisë pranë Akademisë Joniane të Mësuesëve në Korfuz]. Korfuz, Tipografia shtetërore.

- Nahtigal, Rajko (2015). “Mbi alfabetin e Elbasanit dhe letërshkrimin në të”, në *Për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe*, Prishtinë (54), 61–90.
- Omari, Anila (2018). “Tradita letrare e Elbasanit si pasojë e iluminizmit gjuhësor me rrezatim nga Voskopoja”, në *Qytetërimi i Voskopojes dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*, Konferencë shkencore ndërkombëtare, Tiranë, 278–293.
- Qirjazi, Dhori (2015a). “Një motërzim i panjohur i “Bletës shqiptare” (Athinë, 1875) si pikënisje për botimin e plotë të “Bletëve” të Th. Mitkos”, në *Konferencë shkencore ndërkombëtare kushtuar jetës dhe veprës së Thimi Mitkos në 195-vjetorin e lindjes (përmbledhje materiale)*, Korçë 25-26 mars, 39–56.
- (2015b). “Tri dokumente për shqipen dhe shqiptarët, të viteve 1850”, në *Studime në nderim të prof. Francesco Altimarit me rastin e 60-vjetorit të lindjes*, Tiranë, 555–71.
- Rugova, Yll (2023). “Murtaja në Elbasan dhe shkrimet shqip të Theodor Haxhifilipit”, në *Antropologji*, ASA, Tiranë (1), në botim.
- Shuteriqi, Dhimitër (1954). “Dhaskal Todhri”, në *Buletin i Institutit të Shkencave për Shkencat Shoqërore*, Tiranë (4), 35–55.
- (1959). “Shkrime të Dhaskal Todhrit dhe të pasardhësve të tij elbasanas, shoqëruar me fjalorin e shkrimeve të Todhrit”, në *Buletin për shkencat shoqërore*, Tiranë (1), 165–198.

Teksti i transliteruar:

f. 34r Për të Katiqismen |

§. 1.| Besa (thoot shën Pavli) asht prej të nëgjumes | ene enëgjumeja asht prej fjalës Perndiis. “në | qooft se sënëgjjon pra njeriu nuk asht me mëqym |⁵ të mbesooj, ene prej këndyj del iktizaja që | të mësooj ingështeni besën e vet përpara pa upag-|zoo, demek pa ubaamun een[e]¹⁵ epastër ekishës zo-|tit Krisht. ajo emësumeja me gooj ebesës ithoon | edhe quhet gërqiisht Katiqisis, qi do me thaan shqip |¹⁰ nji e xanme ja edhidhaskme besës.|

¹⁵ E-ja në fund duket të jetë shtuar më vonë, qysh vërehet nga ngjyra tjetërfare e shkronjës. Ka gjasë që kuptimi këtu original është “enë” edhe jo “ene”.

§. 2. Nuk gjindet nonji njerii sado itraash që të jelet që të thoot se mundet të xaaj vetës një marifet | ja një zanat pa emësuum një heer përpara ke usta|aj. Po jaan me gjith këtë shum njeerz që kujtoojn |¹⁵ se me qeen një njerii ighështeen, demek të ngjofi etëma|rri vesht perndiin qysh asht, tyeqeen ene kjo një za|nat më vete ma i zafmeçëm se gjith zanatet, ikaston veç të pagzohet ene të quhet ighështeen.|

§. 3. Sa zit vete ky naam me të shejtënushmen | ^{f. 34v} kaart, me adetin ekishës vjetër, ene me atë | llafen edreejt, ene sa imath ashtë telef i shtëpelsës ghështenvet që del nga aji mend do tama-|rri vesht aji që të vëzhgooj e të zgjedhi me mu|kajet këto llafe të rëposhme. |

§. 4. Ipari zoti yn Isisu Krishti që mbarooj shtë-|pesën toon, kur çonte athere çiraktetinjë të |⁵ qiriskin besën, iporosiste të dhidhaskin përpa-|ra miletn[a] te njerzvet mbasandaj ti pagzoonjën | gjith të shejtënushmen ymrin etinjë eshkooj gjithnji | tyedhidhaskun njerzit, sa në për kishat në për shtëpi-|jat, ene shumë hera në për udhët atë besën eree |¹⁰ që kastile udërguu pri babaajit qillit ta ha|shiqerooj më xhetin enjertzillëkut. Këci farsooj ban|te përpara zotit Krisht ene shënjon Prodhromi ka-|tiqiste përpara njerzit përzotnekrisht njani i pag-|zonte.|¹⁵

§. 5. As gjakundi nga istorija apostojet nuk du-|ket shkrumun të kishin pagzuun ata nonji heer | pa katiqisun përpara. Ato rrii mii shpiirt që | ukëthyyn sefte eubaan të ghështeen mbas sëhyp-|^{f. 35r} mes në qiill zotit (demek shën bubit) u pagzuun | mbasi ukatiqisën prej shën Pavlit shumë koho. | ene shën Filipi përpara ep haber për zotnekrisht | mbasandaj pagzon, përpara Katiqis evnuhun | mbasandaj ezbre nduuj, të mos e baajm të gjaat |⁵ gjith kund ka përpara ecte ekatiqisemeja se pa-|gzimi më gjith anët përpara dhidhaskesh ighësheni | njani pagzohesh.|

§. 6. Adeti kishës vjetër nuk ishte tjetër soj ene | prej adetit atyne apostojet, sikundër duket |¹⁰ ene nga shumë vende që zee me ngooj istorija ki-|shës, po mafort prej këci kanonesh që kaan | lidhun Agjii paterët kur mëshilleshin ebaajin | sinodhe, si prej këti të gjashtit (1)¹⁶ të dymëdhi-|tit që ulith prej Sinodhit që ubaa në Neoqesa|¹⁵riit të dyzetepistit në karthagjentë Senodhit, e-|ne të dyzeteshtatit Sinodhit që umështuull në Llaodhiqiit. mato Kanone kërkoon paterët të ngjo|ftmen ene ikrarin ebesës përpara pagzimit | me dashuniin etyne. Po mbasi ubaa adet nëki|^{20 f. 35v} shët nashti këci vakti që të pagzohen foshje, e-|katiqisemeja me gjith këtë nuk jeti meet, as nuk | eshifte me uudh kisha pagzimin pa të katiqisimen | prandajta mbasi pagzoheshin një heer femii foshje | katiqiseshin njani mbas ca koho si të rriteshin etë |⁵ venjën më vëxhuut që të marrin vesht ato që smunde|shin ti marrin përpara pagzimit nga axhamillë-|ku tyne, eban ispaat këtë adet që kapaas | kisha për të katiqisimen

¹⁶ Kjo funksion nuk është përcjellë me ndonjë tekst. Në botimin origjinal greqisht ka shumë fusnota të cilat janë hequr nga përkthyesi në parathënie.

ene kjo esotçme ekollo-|ndrismeja nunvet toon, pse; se meqen çiktizaa |¹⁰ kishim na kur pagzoojm të marrim nuun, përveç | nga ajo iktizaja të katiqismes, nuni nuk mirret | në pagzimtë për tjetër sebeb përveç për qef[i]l | me ekatiqiis njani të pagzomin kur të vinjë më vër|cët sëfolmes. Po çunqi llafen ekemi për ki-|¹⁵shën evjetër, nuk dotjeet përjashta meramit të kalpërxeemj prej këndyj etëshkruujm për mi ato që | uthaan njer nashti ene istoriinekatiqismes, (demek | qysh ene çfarsooj, ene çfar njerzish kaan | katiqiis ma përpara) me maarr vesht gjith se kush |²⁰ bestaar sa mukajet kishte kisha që të bahen [të] |^{f. 36r} katiqismet me task ene rregull prej njerzish të diçun.|

§. 7 Mbas apostojsh ma të paar Katiqistaar të ki-|shës kaan qeen ata veet dhespotllarët sikundër mi-|rret vesht prej nji shkroje të shën Amvrosit. Herhera | gjene katiqisin prifnit ene dhjakët sidozoto shë-|⁵njon Hjrisostomi në andijakhiit, ene shën qirilli në | Ijerusalimt më atvakt kur ishin priftën, ene nji | dhijaku kishës Karthagenit që equuajn Theohjar, shum | hera katiqisin ene ata ma të poshtmit se prifnit, | sikundër Origjeni tyeqeen anagnost Katiqiste në |¹⁰ Aliskandhriit. Kan qeen ene graa dhijakesha katiqistare që katiqisin veç graat. | §. 8. Prej këci yrneku të Origjenit, të shën qirillit,| ene shënjon Hjrisostomit mirret vesht sa mukajet kishte | kisha për me ubaam kjo puneshejtënushme të Katiqi-|smes prej njerzish të diçun jo veç nga ditunija shej-|¹⁵tënushme, po ene nga ditunija përjashme të dynja|llëkut. Këci sooj të diçëm Katiqistaar kan qeen | në skoliit Aliskandhriis me naam Partenos Klimi | Aleskandhrefs, Oigjeni që zuum me ngooj përpara, | Irakllaj, Dhijonisi, Athinodhori, Mallkhion Dhidhi|²⁰ f. 36v mos, Athanasi, ene aji ipabesi Arijos pa e-|nxjeerr atë mulesën ebesës shtirme. Mjaft folëm | për Katiqistarët, nashti ashtë iktizaja të flasim | disa ene për të Katiqismit, ene përpara për vër|cën etyne.|⁵

§. 9. Mbase jete adeti të pagzohen të bit ebestar-|vet foshje munden të hyyn më numrit atyne qi ka-|tiqisen at ças kur vinjën mat vërc që të mirrin | vesht të dhidhaskmen ebesës. Po të bit eatyne | që kishin bees tjetër shtat vjeç etetpoosht, duket |¹⁰ prej nji karshillëku që ishkrueen njiu Timotheus | se ata ekishin izmin të numurohen baashk me të | Katiqismit. në qoofit (pytet aji Timotheu) nji | çun tyiukatiqisëm shtat vjeçja njerii tamam se | nuk edi emerr nafoor ekungon çfare gjaan tëba|¹⁵het për atë; (përgjegjet Timotheu) gjaan të pa-|gzohet çun që nga Pirndija uthirr që të marri na-|foor e të kungooj.|

§. 10. Vakti sa gjante të rrinjën të katiqisen u-|vuu gjiçfarsooj domethaan sa uvuu nji heer su-|²⁰vuu nji heer, si uvuu më nji vend suvuu me nji vend,|^{f. 37r} po gjith këto baheshin si takërkonte iktizaja, shum | hera sado që tishte mururi katiqismes pritesh për | disa vakte të iktizashëm që baa[nj]ën vakii siku|ndër të thomi për tësëmunët eshtatit kur ishin më telef | të vdekes. jahot për me këthyym nji millet të taan,|⁵ ende për të tjera disa këcosh ikonomiish ipagzoo|njën pa ukatiqiis sa ishte iktizaja, çun qi ene | sinodhi që ubaa në Agathë ep izën që të pag-|zohen ata që jaan tyeukatiqisun kur gjinden | më telef të vdekes.|¹⁰

§. 11. Yrneku qysh katiqisen të ghështenët ashtë këci far-|sooj, sikundër urdhënoojn Apostojt. Aji që do | tëkatiqiset fjalën ebesës dreejt, let xaaj etë marri vesht një her pa upagzuum të ngjofmen ati të | pa lemit (domethaan babaajt) masandaj të ngjof-|¹⁵men ebirit leem (domethaan Ijisu Krishtit) mbasa|ndaj të ngjofmen e shpirtit shejt. let xaaj të vu|men me rregull gjiçfarsooj ndërtese, mukajetën e | perndiis që kaa më gjith ndërtesat eti, let marri | vesht gjiçfarsooj nome që jaan vuum epunohen |^{20 f. 37v} me drejtëni, let marri vesht pse ubaa dynjaa ende njeri-|u që rrii m atë, let ngjofi farin evet çfar sooj a, | let marri vesht qysh i mundooj perndija njerzit ekëqii | me zjarr e me uuj (me uuj kur mbyti me Katakliis-|moon, me zjarr kur doq Sodhomat ene Gomorat) ende |⁵ shijtorët inderroj mas gjithsecin millet. Let marri vesht | përzotnekrisht që muur shtat eubaa njerii, Hem për | të vujtmit tii Hem për të ngritmen prej vorrit, e-|ne të hypmen në qiill, tmosengjas let xaaj ene | gjith ato të tjerat që jaan shkrumun më katiqi-|¹⁰set. ishte pre ekatiqismeja qi emështjellme shkurt | fjalvet dhijatës vjetër ene sërees, që mirrte mbre|na Hem shartet eperndiis Hem porosiit eatii. | Mbasi emurëm vesht pra njer nashti fort miir se sa | eiktizashme qenka më të ghështenët kjo pune shejtë|¹⁵nushme të katiqismes që ekemi laan sot kaqë | fort të purtushme a iktizaja ene ekemi boorxh të | madhe të çallstisim që taveem më rregull atpuun për | shtëpesën e shpirtnavet toon, nde mos thoot gjithsekush | se kemi porosiit ezootit ene nambastoojn ato për |^{20 f. 38r} shtëpesën toon kur idiim eirruujm, se ato porosii | gjith themelin ekaan me shartet eperndiis. Në qooftë | praa se nuk evee kush përpara këtë themel të miir, | ndërtesa atii dotjeet gjith herat më telef të bjeer, | aji njerii dot jeet si kallami që këthehet e përkë|⁵thet prej erës, ditunija tii tyeqeen pa themel | dot shahet më xhdo vakt si ata fillosofët eelenvet | tpabees, ene besa atii tyemos qeen me rraja do | të laaj pa ndifun në vakt të cytmes shejtanit. | Po sotmesot të mos marri vesht kush besën e vet nuk |¹⁰ numurohet për gja hiç, ene ajo epamarrme vesht | (kush e di!) ka zaptuum jo veç ata të pa ditmit ene | të trashët, po kjo ka voojt ene ke ata të vjef-|çmit e të këndushmit njeerz, sot nuk ashtë nonji send | ma hashiqare më dynjaa për veç se të shofi kush |¹⁵ njeerz të nderçun e të diçun mos keen haber fare për | besën e tyne. Po çmirret vesht prej këndy; një e-|dalme përjashta udhës, me mina fiqire të kota, ene | dhisidhemon|i|i (domethaan friik ekoot më të shejtënush-|met puun) kemi friik atje ke sashë për të pasun |^{20 f. 38v} friik, ene kuxoojm atje me gjaan të kemi friik, | nuk ngjofim atë që ashtë faal prej asaaj që | ashtë mb|i|dhisun, gjithse kush kërkon të vetën ene | as nonji të tjetrit, po pse; se ndërtesa joon | nuk qindron më themel të sakët. Çunqë nuk |⁵ u katiqisëm udhën ezotit sikundër gjante më at-|vakt kur ishim më vërcët njoom, që ene të metat | enjeriut sishin niis të këthehen hala të baheshin | huqe, ene mendja sishte errsuum prej tymit a-|tyne që na kanda na uudh. let vëzhgooj gjith se |¹⁰ kush me mukajet, ene aji bile që edi veten për | të dreejt zemrën eti ene do ta marri vesht se sa | fort gënjehet. Shpresa nuk ashtë kuurr eqindru-|shme kur skaa themel haberin që

kaa boorx gjith | sekush ta keet për besën etii, ene aji haber nuk ^{|15} fitohet tjetër ndryshe për veç me të vëzhguume e | me të pytme, domethaan me një të katiqiseme me task.|

§. 12. Po beqim del nonji kundër ethoot këto të | parën heer, se sot nuk katiqisemi nga sebepi | që pagzohemi foshje. të dytën, se embushin kë-^{|20 f. 39r}të të meet së katiqisemes ata telallët ebesës që na | baajn dhidhaksii në për kishat. të tretën, se as nuk | ashtë eiktizashme ekatiqisemeja çunqi ighështeni kaa | boorxh të mbesooj pa vëzhguum.|

§. 13. Ene më të parin kundër qi thoot se sot nuk ^{|5} katiqisemi nga sebepi që pagzohemi foshnje, ju-|përgjigjemi kështu. se mbasi jeti adeti të pagzohen | foshje, kisha me gjith këtë nuk epërtooj këtë punën | e katiqisemes, po mbas pagzimit idhidhaskte bet ebe-|starvet besën, se vinjën m atvëerc që mirrin vesht ^{|10} të mësumen ebesës, me mos ezgjaat llafin shif a-|to që ufolën për këtë ma përpara.|

§. 14. Idyti kundër gjene sa fort epafuqishëm a | mirret vesht prej këndy, se Tellalët e besës që | na baajn dhidhaksii flasin ma tepër nga ajo aan ^{|15} ebesës që rrëfen për porosiit e tii perndiis, po | jo nga ajo aan që rrëfen për të ngjoftmen e tii, | çunqi ato ezaan të jeet ikatiqisëm përpara | nëgjuatari, ene puna atyne nuk ashtë të katiqi-^{f. 39v}sin, po të rrëfeejn udhën edreejt nga gjaan të shkoljim, lateshpi ata flasin primi hajdutillekun, e-|thoon se ashtë porosija perndiis “tmos vjedhish” | dëfteejn me shum ispatllëqe të shejtënushmes ka-|art ene të Agjiipatervet se sa pune keqe ashtë ^{|5} hajdutilleku, po për me paas fajde ighështeni | që dhidhasket, ene me maar friik prej ati gjyna-|fi, iktizaja ashtë të marri veshtë kush ashtë aji | perndii që ban tembi për atgjynaf, cit jaan | ato huqet emira tatinjë që skaan numër, ene ^{|10} ato ndere pa hesaap më nee që prej atyne del | borxha që kemi të jemi më intaat porosivet a-|ti ténaltit nomvumit. gjith këto jaan [A]ar | të katiqisemes. Ene në qooft se sot pak faj-|de biin dhidhaksiit e telallvet besës sashhtë tje-^{|15}tër sebep për veç se nëgjuatarët sjaan katiqi-|sum ma përpara. Kisha vjetër dhidhaskte ma shpe-|esh se dhidhaskin sot, çunqi kuurr nuk mështilleshin | nonji heer gjakund ketmos qiriskesh fjala perndiis | prej dhespotit vendit, po me gjith këtë nuk ezin-^{|20}te të tepme të katiqisemen. joo! hiq nga aji fi-^{f. 40r}qiir! po bile edinte fort të iktizashme sinji themel | që ndërtonte njani primi atë të ditpërditçmet dhi-|dhaksii.|

§. 15. Për me zgjidh ene të tretin kundër [“]që thoot | se ighështeni kaa boorxh të mbesooj pa vëzhguum, ^{|5} iktizaja ashtë të zgjedhim etë marrim veshtë në qooft | se xhdo evëzhgume për besën ashtë pa izën. Ijalpokalipsis ashtë një ehashiqarume të vërtetavet, që | ubaa me thavmë prej perndiis fuqimadhit. mbasa-|ndaj ajo Ijapokalipsis merr mbrena ca puun që ^{|10} smundesh kuurr ti marri veshtë njeriu veç me fuqiin | emendis tii, po ato tpa marrme veshtë jaan lidhun | baashk me të tjera që mundet ti marri vesht njeri-|u ene pa tinapokalipsin. xhdo puun që kaa | gjyq kaa ene ispat, mbasandaj ene të vëzhgume, ^{|15} ene mjer më të ghështenët në qooft se besa atyne | (demek ilmi

hooll esëngjoftmes perndiin) nuk kishte mar-|tisii. Nji bees këcifarsooj si jooona që ashtë mbaj-|tun më nji shpirtënisht fukarallëk, më nji durim | të ngamevet, më nji luft të ditpërdisëm ndër-^{20 f. 40v}mjet shtatit ene shpirtit, nji uudh të thomi kaqë | fortë enguusstë eesikletçme nuk ishte me mëqym | kuurr të këtheej prej besash të huja jo me mi-|liuna njeez po ene nji të vetëm njerii në qooft | se skishte martirii. Ilaqim aji dyzeni çudi-|⁵çum që a ndërmmjet shartevet nde porosivet per-|ndiis, ato çeftësinat etii që jaan lark me-|ndes toon, ato profiitiit që uhashiqaruun e | dulën gjith të vërteta pa nonji reen, shejtëni-|ja atyne që kan shkruum ungjijet, gjith këto |¹⁰ jaan kaqë ispatllëqe që fuqija atyne shtë-|^gngooj kaqë miletna njerzish të braktisin | nji uudhë të gjaan që kan passhkuum të at-|nit etyne, etë bahen kail të hyyn më nji uudh | të ^gnguuusstë të zotit. Kjo evëzhgume pra këty-|¹⁵ne farsooj ispatllëqeve jo veçe ashtë me izën | po ene fort e iktizashme, çunqi pa atë të vëzhgu-|me nuk ashtë me mëqym të marri veshtë njeriu, e-|ne posmuur vesht sasht me mëqym të leej ne nji | ^{f. 41r}heer (domethaan të përtërihet etëlahet në nji heer | nga gjynafet enjeriut vjetër), nuk asht me mëqym | të prokopsi kuurr më të mirët. Shën Pjetri çun|qi edinte se sa eiktizashme asht emarrmeja vesht | besës nadhidhask e nathoot “të jeni gatii për-|⁵hera për me jupërgjeegj kujdo që tju pysi juve | për shpresën që keni më besët. Aji zoti | Krisht urdhënon që të vëzhgoojm shkrojat eshejtë|nushme. Apostojt thoon për ata sojlit çifutët | se eprisin fjalën eperndiis me gjith eshtatye |¹⁰ zgjedhëm evëzhguum ditpërdisit shkrojat eshejtë-|nushme pale ishin aci sooj sikundër dhidhaskeshin | prej Apostojsh, evëzhgumeja tyne jupruu të marr|men vesht ene emarrmeja vesht jupruu eshtafin. be-|sa të ghështenvet kaa xhevaap, nde mbasandaj të |¹⁵ vëzhgume ene ispaat ene nuk ashtë mëshitetëm më | rrena të shpifme me zanat që viin kundër me | llafin edreejt sikundër jaan besat etjera. | Po çunqi këcifarsooj asht besa toon, pse të | ^{f. 41v}kemi friik të vëzhgoojm pale asht aci sooj.|

Me mosdaash kush të vëzhgooj besën evet ashtë | nji adet që ekaan besat etjera se me të vëzhgu|men kaan friik se judel reen ekopile. Po | besa të ghështenvet skaa friik të vëzhgumen,⁵ stremet sepse ta zgjedhi anjer më nji fije. Kollu-|ndrise praa O ighështeen gjith fuqiin emendis, | gjykoji besën tate me të foort, mos kii friik | tanxjerrish përpara gjyqit llafes dreejt nde ta | bajsh yrybaa me besat etjera, zgjidhi shahi-|¹⁰tët ekësaj bese vëzhgooj palegjinden më nji lla-|fe të gjith apo kishin nonji meram tatyne të | rrenjën. Ban yrybaa istorii me istorii, va-|kte me vakte sa ma tepër të vëzhgojsh aqëma|miir dot marrish vesht ene të do gëzohesh se ske |¹⁵ qeen gënjymun. Anjer më këtë vëzhgimi nuk asht | veç me izën po ene fort iiktizashëm.|

§. 16. Po mbasi emerr vesht se kështu asht puna mos | të vii inaat se gjeen më besët ene disa puun | që smundet ti nxaaj mendja ngusht toon. |^{20 f. 42r} Sikundër kee boorxh tazgjedhish pale ashtë nga qilli | (si ebaajn nakël shkrojsit) ashtu gjene kee bo|orç tmos e hodhish poosht sepse kaa ene disa të | çefta e tpamarrme vesht, se me qeen tishin të gjitha | të marrme vesht sishte iktizaa të

na e dëftonte per⁵ndija veet këtë bees, a të kryqzohesh për nee|nji nga shën Triadha, po mostonte menndja nje|riut ti dëftonte gjith se kuuj udhën e vërteet që | nxiir me të mirët shpirtit. Po mendja njeriut | erth euerrsuu euprish fare nga gjynafi, ene nuk |¹⁰ dinte a nuk mundesh të gjeej hilaçin e kësaaj | prishje gjith njerzvet që të pajtooj me baba-|un e qillit toon që me prijti ishte zemëruum pri|mi nee, ishte praa iktizaa ta gjjej dermanon | ditunija epa fundme perndiis e ta veej më puun |¹⁵ fuqija madhe tii. gjynafi ishte fort i math | se ubaa ke imathi zot masandaj gjante tishte i-|math ene rixhali që do bante hoshnuut drejtë|niin emadhe të perndiis. Gjith ato tufat e e|njujvet të ishin shtatuum e kryqzuum për nee |²⁰ nuk dotishte me mëqym kuurr të resiteshin gjyna|^{f. 42v} fet tona, çun qi ne ata jaan se na ndërtesezo-|tit. Nuk mbet praa tjetër, për veç një perndii | uhashiqaruu mi shtat, ukryqzuu uverruu, u-|ngrit, ene hyni në qiill. Aji kishte këtu më | dhee çiraak ene çirakët etii e baan ispaat |⁵ të gjith me një gooj anjer më vdeket tyne, në | tukambush mendja se ispatllëku atyne ashtë | i vërteet, mos kuxo të shkojsh matutje etë | thuush qysh bani biir pirndija, qysh asht | me mëqym të piqet firi perndiis me fisin |¹⁰ e njerzillëkut, jahut të pjelli virgjineesh, | mos bahu mukajet të kërkojsh këto pu-|nësh të këqija që shyyn në menjji far udhe, | po thuu me gjith eshk të zemrës tpa fu-|qishmit ke njerzit jaan të fuqishmit ke |¹⁵ perndija.|

§. 17. Mbasi uujdisën praa kundrat (si kuj-|toj) fort miir, mbasi ubaa ispat prej të | shejtënushmes shkrooj, prej adetit kishës | vjetër, ene prej llafes dreejt iktizaja që |^{20 f. 43r} ashtë për me ukatiqisëm i kështeni besën e tii | ishte me nasip të ipesh një këci farsooj Kati-|qisis më të ghështenët që mbasi tja mësoojn | bariit dhenvet tyne, print bivet tyne, nu|nët të pagzumvet tyne, ene mos ingjas gjith të |⁵ diçmit të paditmvivet, të vihet ene sot ky a-|deti nderçum i kishës vjetër, ene të mirosen | huqet e këqija, nde mbasandaj të marrin fajde | të kështenët nde nga shpirti.

Ky ashtë aji ndje-|ti im praa që, masi gjeta këtë Kateqise gër|¹⁰qisht që ekaa nxjeerr Koraiu, ubaash mukajet | nde un e exora më gjuhunët shqipes toon për | fajden e gjith hrishtënimit. Shtova m'ate ende | disa të nishanume rëposh sa kaa iktizaa gju|huna shqipes të rrëfeej nojmat e gjuhunës gër|¹⁵qishes. Jukam rixhan praa juve të ghëshen-|vet shqiptarët të dheskni e ta duni këtë Kati-|qise si ushqimin e shpirtit tuuj, ta meletisni | e ta këndonin përhera në daçi të merrni nate-|

^{f. 43v} diit të lumnumen prej zotit, në daçi ti | bini pishqesh ndërtestarit toon të ngjoft-|men eperndiis që asht si një kurban i shejtë-|nushëm e i pëlqyshëm ke aji që pa ibaam | këtë kurban nuk a me mëqym kuurr të for-|⁵cohi, më besët nde më punët emira. Nxintoni | shpejt praa O të ghështeen tja ngulni ndër|mend këtë farsooj të ngjoftme perndiin ene bivet | tuuj anjer sa jaan të vegjël në daçi ti mëso-|ni dituniin e vërteet që asht e fajdellëcshme më |¹⁰ shpirtin se pa paas atë ditunii xhdofarsooj | tjetër ditunije ashtë budullallëk ma fort. Ene | më atë që kaa fuqii tna [r]uuj nga gjynafet e tna | veej të rrim me gëzim përpara laftit tinjë

| më atë të vetmin, themi, të diçmin tepër perndii |¹⁵ shtëpestarin toon qooft lafti, madhënija, fuqija | ene urdhënimi nashti ene gjith motnejtës. Amin. |

f. 44r AAN EPAAR |

— |

për

tëngjofmen eperndiis vetëm qënaçon dreejt |

Ke besa ongjillit. |⁵

— |

ispaat se ka perndii. |

§. 1. Gjith na njerzit jemi jeratiis me mend, që me atë | mundemi të gjykoojm çdo puun për me e maar vesht so-|jën e asaaj anjer më një fije. Në qooft praa se |¹⁰ me këtë mend zgjedhim e gjykoojm nde atë soojn toon të | njerzillëkut marrim veshtë se nuk ishte me mëqym të ndër|toojm na vetveten toon (1) prej kësaj llafje mirret | me kijaas se ashtë me tvërte një send i pagoditme ene fu-|qimadhe që nandërtooj neve nde gjiith ndërtesat e tjera, |¹⁵ (2) nde ky farsooj send ashtë perndija. |

(1) Saa shofim më këtë dynjaa munden të ishin ja të | mos ishin, jahut tishin tjetër ndryshe. Po kur del | eshpifet nonji send më të qenmet që seka paas no|nji heer kuurr, mirret me mend fort miir se ekaa ndër|²⁰tuum kush. Prandaj ene profeti dhavidh (psalm. 99. 3) | f. 44v thoot “O zot ti nandërtove neve ene jo na. |

(2) Prandajta uqujt ene njeriu dynjaja vogël që | epamja atii naçon ke perndija. |

§. 2. Hashiqarohet gjene eqenmeja perndiis, të parënheer, |⁵ prej sëpames kësaj dynjaje (1), të dytën, prej i-|krarit gjith miletnavet edynjaas (2), të tretën, nga | epërbrençmeja emarrme vesht zemrës toon (3), ene | tëmraani, prej të përbrençmit ashkut zemrës | që kaa të fitooj atë ma tëmirën ma të fajde- |¹⁰llëkshmen ene ma fatmirllëkun (4). |

(1) Kjo dynjaa asht një sejër që shofim matë la-|ftin eperndiis. Asht si një vevllii që dëften mbre-|na të zotit ensaaj që ekaa shkrumun. Ashtë | një paasqyyr qi duket mbrena ditunia perndiis. |¹⁵ Këtë eban ispaat ene një nga Apostujt (rom. a. 20) | që thoot “Ato të papamit etinjë (perndiis demek) | përpara pa ugodiit dynjaja duket sot të ngjof-|tme prej ndërtrash fuqija madhe tii themi ene per- |¹⁹f. 45r ndillëku. |

(2). Më gjith anët edheut ndërmet bile ene atyne ma | të egravet miletnavet duken vomi (a) më gjith anët | therin kurbana njerzit. Kaqë fort ashtë nguul keze-|mra njeriut eqenmeja perndiis saqëma fort do të |⁵ lusi guur egjiçfarsooj tjetër plaçke se të mbesooj | që skaa perndii fare. |

(3) Gjith se kuuj njeriut zemra indiin gëzim më pu-|nët emira, ene më punët eliga iidhënohet ene ivjen | keq fort. Gjith kjo vjen prej një send fuqije që |¹⁰ nashtërngon domosdo të mbesoojm se ashtë një gjyqta-|lar, fuqimath, mirbamës qi shpaguun punën emiir | ene mundon pa mysade punën eliig. Kështu thoot një | shën Pavli (rom. 2. 15). |

(4) Sado fatmiir me qeen njeriu këtu më dynjaat, sa |¹⁵ ma shum të mira të trashigooj gjene nuk mundet kuurr | tambushi atgi|st|aar evet me aqë të mira sa ikërkon | zemra ene satmos iprishet qejfi nonjiheer kuurr më |

— |

(a) ikaan elinët si kisha ene më ato therin ene kurba-|²⁰nat e tyne. |

f. ^{45v} ymrit tinjë. Sollomoni mbasi trashigooj këtu më | dynjaat gjiçfarsooj qejfi. Thirri njani cëmbrapni | etha. “gjiith të kota! po çunqi një këci farsooj | gidaje qi ekemi në firtë nuk udha kot më nee, mu-|ndet qi të mbushet ajo gidaja Joon prej një të mire |⁵ qi ashtë primi të gjitha emiir. Cila ashtë ajo emiir; | ashtë veet perndija sikundër thoot nde profeti dha-|vidh “kam me unguimën o zoot kur të shof laftin | tat. |

SUMMARY

THE ELBASAN CATECHISM FROM MID 19TH CENTURY, WRITTEN IN TODHRI SCRIPT

Among the documents located at the Central State Archive in Tirana is a notebook from Elbasan with writings in Greek, among which there are also several pages in Albanian with Todhri's alphabet. At least the copying of the text, as other authors have noted, comes from the second half of the 19th century. The content of the writing is a catechism published by the influential Greek scholar Adamantios Korais (1748–1833) translated into Albanian by an unknown author from Elbasan. In this article, we are publishing for the first time in a transliterated form the complete Albanian text of the notebook, accompanied with the latest known information related to it. As seen from the name written in some pages, its last owner was Petro Shuteriqi, who might also be the author. Though based on the language characteristics, it seems plausible as well that the translation itself comes from a later date. The original text of Korais was published in 1782, a date that we propose as *terminus post quem*. Based on words used, and the way they are written, older Elbasan authors (including Theodhor Haxhifilipi himself) cannot be excluded as authors of the translation. Albanian language specialists, using the published text here, could help further clarify the issue of authorship. The document, first mentioned in 1954, is important because it is the best visual example of a writing with Todhri alphabet to date. Its value is further elevated from the content of the text itself, as some original fragments in the preface represent rare fragments that could cast some light into the underlying reasons of authors to engage in such Albanian translations. The complete publication of this text, we hope, can also influence the clarification of other unknown issues related above all to the time it was written, its context, and the probable author of the translation.

